

FOL

FTESË

**I nderuari z.Elezaj,
Kryetar i Komunës së Klinës**

Lëvizja FOL është duke bërë monitorimin e disa komunave në Kosovë sa i përket investimeve kapitale.

Në komunën e Juaj janë vlerësuar investimet kapitale të planifikuara, të parapara me plan të prokurimit, dhe të realizuara përgjatë vitit 2018.

Andaj, Lëvizja FOL ju fton në një debat publik në formatin "FOL Hapur", i cili do të mbahet në komunën e Klinës, ku me prani të banorëve do të diskutohet planifikimi dhe realizimi i këtyre investimeve, përfshirë këtu nevojat eventuale të banorëve për investime të tjera kapitale.

Debati është paraparë të mbahet me 14 Maj 2019 nga ora 11:00 në sallën "Jehona e Dukagjinit" në Klinë.

Ne mbesim me shpresë që Komuna e Klinës do t'i ftojë qytetarët në debatin "FOL Hapur", në mënyrë që të përfshihet një pjesë sa më e madhe e publikut.

Për informacion shtesë ju lutem kontaktoni *Elbasan Racaj* , email: elbasan@levizjafol.org ose në tel: 049/716 222.

Me respekt,

Mexhide Demolli-Nimani
Drejtore Ekzekutive
Lëvizja FOL